



Shtator 2024

Të nderuar pjesëtarë të klasës së vitit 2026 (që hyni në klasën e njëmbëdhjetë) dhe prindër/kujdestarë të klasës së vitit 2026:

Nxënësit e klasës së njëmbëdhjetë të këtij viti janë klasa e parë që diplomohen, të cilëve u kërkohet të përmbushin standardet e reja të kalimit për kërkesën e Përcaktimit të Kompetencave (Competency Determination, CD) të MCAS në artet e gjuhës angleze (English language arts, ELA), matematikë dhe shkencën e shkollës së mesme. Shpresoj që kjo letër do t'ju ndihmojë të kuptoni kërkesat e diplomimit për klasën e fëmijës suaj.

Më 15 gusht 2022, në mbledhjen speciale të Bordit të Edukimit të Shkollës Filllore dhe Sekondare, Bordi votoi për të përditësuar kërkesën CD duke filluar nga klasa e vitit 2026. Standardi i ri përcakton pikët kaluese minimale në ELA, matematikë dhe shkencën e shkollës së mesme për t'u diplomuar nga shkolla e mesme. Studentët në klasat e vitit 2026 deri në vitin 2030 duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme që të kualifikohen për një diplomë të shkollës së mesme (përveçse të përmbushin të gjitha kërkesat vendore për diplomimin):

- të fitojnë një rezultat të shkallëzuar prej 486 pikësh ose më shumë në testet ose ritestet e ELA dhe matematikës; **ose**
- të fitojnë një rezultat të shkallëzuar prej 470–485 pikësh në testet ose ritestet e ELA dhe matematikës dhe të përmbushin kërkesat e një Plani të Aftësive Mësimore (Educational Proficiency Plan, EPP) në atë lëndë (www.doe.mass.edu/assessment/epp). Çdo EPP do të përfshijë një rishikim të pikave të forta dhe pikave të dobëta të fëmijës suaj, kurset që duhet t'i ndjekë dhe t'i përfundojë në klasat 11 dhe 12, si dhe një përshkrim të vlerësimeve që shkolla do të kryejë për të përcaktuar nëse fëmija juaj po fiton aftësitë e nevojshme; **dhe**
- të fitojnë një rezultat të shkallëzuar prej 470 pikësh ose më shumë në testin e biologjisë ose hyrjes në fizikë të shkollës së mesme.

Nëse fëmija juaj nuk ka përmbushur kërkesat e MCAS për diplomimin në një ose më shumë lëndë, ai ose ajo mund ta përsëritë testin (disa herë nëse është e nevojshme) për të përmbushur kërkesën. Mundësia e parë e ritestimit në çdo lëndë është planifikuar si më poshtë:

- ELA: 6–7 nëntor 2024
- Matematikë: 12–13 nëntor 2024
- Shkencë: 4–5 shkurt 2025

Për studentët që nuk kanë përmbushur kërkesat në ELA, matematikë ose shkencë, Procesi i Apelimeve për Performancën i MCAS u jep studentëve një mënyrë tjetër për të treguar se i zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të arritur ose tejkaluar standardin CD të shtetit. Informacione të mëtejshme lidhur me kërkesat për pranimin mund të gjenden në www.doe.mass.edu/mcasappeals, ose mund të kontaktoni drejtorin ose zyrën e informacionit të shkollës së mesme.

Rezultatet MCAS të fëmijës suaj mund t'i japin mundësi të fitojë një kredit burse për në një kolegji ose universitet publik të Masaçusetsit. Studentët që kualifikohen për bursën John and Abigail Adams (www.doe.mass.edu/scholarships/adams) do të njoftohen automatikisht gjatë vitit të maturës. Studentët që kualifikohen për Certifikatën Master të Stanley C. Koplík (www.doe.mass.edu/scholarships/mastery) duhet të aplikojnë gjatë vitit të maturës.

Për studentët që nuk i kanë përmbushur kërkesat MCAS për diplomimin, ekzistojnë mundësi të tjera falas për t'i ndihmuar për të ardhmen, si programe të shkollës së mesme, programe të kolegjit në komunitet dhe programe pune dhe mësimi. Informacion i mëtejshëm rreth këtyre drejtimeve dhe mundësive të tjera mund të gjenden në <https://www.doe.mass.edu/ccte/pathways/hqccp/default.html>.

Nëse keni pyetje lidhur me rezultatet e testit MCAS të fëmijës suaj, ju lutemi të flisni me konsulentin për fëmijën tuaj. Nëse ai ose ajo nuk mund t'i përgjigjet pyetjes suaj, ju lutemi të na kontaktoni në mcas@mass.gov or 781-338-3625.

Me respekt,

Russell D. Johnston
Komisionari në Veprim i Arsimit Fillor dhe Sekondar

Albanian